

**SABIT SYLA****MARRËDHËNIET SHQIPËRI-KOSOVË NË VITET 1970**

Në vitet shtatëdhjetë të shek. XX, u vendosën kontakte direkte ndërmjet shtetit shqiptar dhe Kosovës. Marrëdhëniet dypalëshe gjetën konkretizim në disa fusha. Përveç marrëdhënieve tregtare u nënshkruan një varg marrëveshjesh të ndërsjella në arsim, shkencë e kulturë. Bashkëpunimi Shqipëri-Kosovë ishte fenomen i ri në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Për herë të parë, që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore, shqiptarët e të dy anëve të kufirit po komunikojnë direkt me njëri-tjetrin në fusha jo aq fitimprurëse, por me rëndësi të veçantë për lidhjet e tyre shpirtërore e kulturore. Sinjalin për të ndërtuar politika afrimi ndërmjet Shqipërisë e Jugosllavisë, me gjithë kundërthëniet që ekzistonin në mes dy vendeve, do ta jepnin të dy udhëheqësit kryesorë të Shqipërisë e Jugosllavisë. Enver Hoxha gjatë vizitave të tij në pranverë të vitit 1970 në rrethet e Kukësit e Tropojës u shpreh qartazi për afrim me Jugosllavinë, duke shprehur gatishmërinë për të mbështetur këtë të fundit në rast rreziku nga jashtë. Mirëkuptim për këtë problem kishte pasur edhe nga ana e udhëheqjes së lartë jugosllave. Udhëheqësi jugosllav Josip Brox Tito në fjalimin që kishte mbajtur në Ulqin në vitin 1969 kishte shprehur gatishmërinë për të përmirësuar marrëdhëniet me Shqipërinë. Klima pozitive në marrëdhëniet dypalëshe u konkretizua me disa marrëveshje konkrete në marrëdhëniet diplomatike ndërmjet të dy vendeve. Më 5 shkurt 1971, qeveria jugosllave e shqiptare vendosën që të ngrënë nivelin e përfaqësimit të tyre diplomatik në rang ambasade dhe të shkëmbejnë ambasadorët përkatës<sup>1</sup>.

Deri në këtë kohë, marrëdhëniet Shqipëri-Kosovë kishin qenë të kufizuara. Ato ishin përqendruar vetëm në fushën tregtare dhe në kuadrin e Federatës Jugosllave apo Republikës së Serbisë, pjesë e së cilës, siç dihet ishte edhe Kosova. Vetëm, pas përmirësimit të marrëdhënieve shqiptaro-

<sup>1</sup> Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës (më tej: ASHAK), Fondi: Sekretariati Krahinor për marrëdhënie me botën e jashtme, viti 1979-1988, Numri i lëndës 36, kutia 3, fl. 1. Marrëdhëniet midis RSF të Jugosllavisë dhe RP të Shqipërisë dhe pozita e KSA të Kosovës e detyrat e saj.

jugosllave, u krijuan premisa për të pasur marrëdhënie të drejtpërdrejta ndërmjet shtetit shqiptar dhe Kosovës. Nevoja për përmirësimin e marrëdhënieve dhe zgjerimin e tyre erdhi si rezultat i faktorëve të brendshëm e të jashtëm. Interesi i qeverisë shqiptare për të pasur kontakte direkte me Kosovën kishte qenë i vazhdueshëm, por udhëheqja jugosllave vetëm në këtë kohë u ndje e gatshme që të lejonte shkëmbimet e drejtpërdrejta të shtetit shqiptar me Kosovën. *Së pari*, faktori shqiptar në Jugosllavi kishte fituar peshë. Ai ishte bërë i rëndësishëm dhe ndikues në balancat e shtetit jugosllav, për të zbutur e ekuilibruar tensionet dhe përplasjet e brendshme politike e nacionale të tij; *së dyti*, përveç këtij faktori duhet marrë në konsideratë gjendja ndërkombëtare në këto vite, nisja e një lloj fryme për mirëkuptim në Evropë e iniciuar nga disa shtete evropiane, pjesë e të cilit u bë edhe Jugosllavia, por jo Shqipëria. Procesi disavjeçar i Helsinkit u finalizua me nënshkrimin e Kartës së Helsinkit në vitin 1975; *së treti*, në afrimin shqiptaro-jugosllav ndikoi gjithashtu rritja e presionit të Bashkimit Sovjetik mbi të dy vendet e në veçanti mbi Shqipërinë, pas daljes së saj nga Traktati i Varshavës në vitin 1968. Secila palë donte të përfitonte nga kjo situatë, për të siguruar ‘krahët’ nga ndonjë rrezik i mundshëm që mund t’u vinte nga superfuqia komuniste; *së fundi*, për shtetin shqiptar bashkëpunimi me Kosovën shihej si mundësi për të ndihmuar e ndikuar mbi shqiptarët e këtyre viseve jo thjesht në aspektin arsimor e kulturor, por edhe në atë ideologjik. Avantazhet e bashkëpunimit të Shqipërisë me Kosovën do t’i nënvizonte e analizonte Enver Hoxha në mbledhjen e zgjeruar të Byrosë së Komitetit të Partisë në rrethin e Elbasanit, më 7 maj 1971.

Afrimi i Shqipërisë me Kosovën, gjeti mbështetje dhe përkrahje të plotë nga pjesa më e madhe e popullsisë shqiptare të Kosovës dhe viseve të tjera të Jugosllavisë, pasi shtimi i kontakteve shihej si një kontribut i madh në forcimin e dashurisë dhe rritjen e admirimit të popullsisë shqiptare për shtetin amë. Kësisoj, që nga viti 1970 u krijuan kushte dhe rrethana të reja të cilat i shfrytëzuan shumë shqiptarë nga Kosova dhe viset e tjera për të vizituar Shqipërinë. Ambasada e Tiranës në Beograd mori 265 kërkesa nga grupe të ndryshme, të cilat të shpërndara sipas viteve janë si më poshtë: 2 më 1970, 86 më 1971, 85 më 1972, 51 më 1973, 13 më 1974 dhe 29 më 1975. Prej tyre janë plotësuar 63 e përkatësisht sipas viteve: 12 më 1972, 3 më 1973, 11 më 1974 dhe 7 më 1975, dhe sipas trevave: 48 nga Kosova, 4 nga Maqedonia, 6 nga Mali i Zi, dhe 5 prej viseve të tjera të banuara me shqiptarë. Shpërndarja e kërkesave sipas trevave ka qenë: 211 nga Kosova,

17 nga Maqedonia, 29 nga Mali i Zi dhe 8 nga viset e tjera<sup>2</sup>. Kërkesat për të vizituar Shqipërinë kishin ardhur duke u rritur nga viti në vit. Në Ambasadën e Shqipërisë në Beograd deri në shtatorin e vitit 1977 ishin paraqitur mbi 10 000 kërkesa individuale për të vizituar Shqipërinë<sup>3</sup>.

Për sa u përket marrëdhënieve ekonomike të Shqipërisë me Kosovën fillet e para të këmbimit të jashtëm tregtar, nisin në vitet gjashtëdhjetë<sup>4</sup>. Ato janë zhvilluar më së shumti me firmat kryesore për tregtinë e jashtme, si: “Kosova-eksport”, “Agimi” etj. Marrëdhëniet tregtare u zhvilluan në dy etapa kryesore: gjatë *etapës së parë*, e cila përfundon në vitin 1971, Shqipëria eksportoi në Kosovë kryesisht artikuj artistikë, si prodhime argjendi, artikuj të skalitur, qeramikë, qilima, pllaka gramafoni etj. Raporti eksport-import me firmat nga Kosova për këtë etapë, llogaritur në 000/ \$ klering, ishte: më 1965 eksporti 149; më 1966 ishte 282; më 1967 ishte 64; më 1968 ishte 128; më 1969 ishte 237; më 1970 ishte 153 dhe në vitin 1971 ishte 222. Karakteristikë e kësaj faze ishte

<sup>2</sup> Nga këto më të shumtat kanë qenë grupe shkollash fshati (63), shkollash qyteti (56) dhe të ndërmarrjeve të ndryshme ekonomike (40); pastaj 26 grupe rinie e studentësh, 43 të institucioneve, 12 ansamble, 10 të ndryshme dhe 8 grupe bujqish nga fshati. Nga 63 grupet e pranuara kanë qenë: 38 grupe shkollash dhe studentësh, 9 grupe ndërmarrjesh prodhuese (prej tyre 2 grupe bujqish e 2 grupe punëtorësh, ndonëse si këta ashtu edhe tjerët kanë qenë të përzier), 9 grupe të institucioneve kulturore-artistike, 2 grupe, njëri grash e tjetri vajzash dhe 2 grupe sportive. Shih: *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë* (më tej: AMPJ), viti (më tej: V.) 1975, dosja (më tej: D.) 651/1, fl. 82-88. Informacion i Drejtorisë IV, “Mbi kërkesat për të vizituar Shqipërinë të grupeve të ndryshme nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi”, 16 nëntor 1975.

<sup>3</sup> *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 14 / (Arkivi i Partisë-Strukturë (më tej: AP-STR), viti (më tej: V.) 1977, dosja (më tej: D.) 540, fl. 1-6. Informacion nga ambasadori Sokrat Plaka, dërguar Sektorit të Jashtëm të KQ të PPSH-së (Pirro Bitës), Beograd, shtator 1977.

<sup>4</sup> Fillimet e këmbimit të jashtëm tregtar ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, sipas një dokumenti në Arkivin e Kosovës ishin në qershor të vitit 1966 dhe pikërisht ndërmjet KBI “Kosmet-Export” nga Prishtina dhe “Agroexportit” nga Tirana, me kontratën e dyanshme të 2 430 tonelatave të llojeve të ndryshme të mallrave në vlerë prej 382 893 dollarë të llogaritur. Pjesën më të madhe në këtë kontratë e përbënin frutat dhe perimet. Ndërsa, sipas një dokumenti të Arkivit Qendror të Shtetit Shqiptar marrëdhëniet tregtare kishin filluar më 1965. Shih: *ASHAK*, Fondi: Sekretariati Krahinor për marrëdhënie me botën e jashtme, viti 1972-1984, Nr. i lëndës 1-97, kutia 4, fl. 5. Këmbimi i mallrave të KSA të Kosovës me RPS të Shqipërisë; *AQSh*, F. 14/AP-STR, V. 1978, D. 301, fl. 2, 26-30. Informacion mbi marrëdhëniet tregtare me firmat e Kosovës, përgatitur nga Jorgo Themeli, Tiranë, 21 tetor 1978.

sundimi i eksporteve nga Shqipëria ndaj importeve të Kosovës. Etapa e dytë fillon në vitin 1972 me krijimin e firmës kosovare “Eksimkos” e destinuar për të zhvilluar tregtinë me Shqipërinë. Në këtë etapë nga Shqipëria filloi eksportimi i kromit për ndërmarrjen “Deva” të Gjakovës, i konjakut, konfeksioneve e sidomos ai i bitumit. Shqipëria filloi të importonte nga firmat kosovare betoniere e pjesë këmbimi, pompa, acid sulfurik, lëkurë, argjend etj. Niveli i eksport-importit për këtë etapë (1972-1978), llogaritur në 000/ \$ klering, ishte: më 1972 eksporti 970 e importi 221; më 1973 eksporti 4 688 e importi 99; më 1974 eksporti 3 555 e importi 462; më 1975 eksporti 2 722 e importi 162; më 1976 eksporti 1 952 e importi 214; më 1977 eksporti 2 473 e importi 436; dhe në vitin 1978 eksporti 2 034 e importi 755<sup>5</sup>. Në vitin 1978, shkëmbimet tregtare të Shqipërisë me Kosovën arritën 3 289 000 \$ (2 671 000 \$ eksporte dhe 618 000 \$ importe). Për vitin 1979, institucionet përgjegjëse kishin parashikuar që gjatë këtij viti shkëmbimet të arrinin në 6 000.000 dollarë<sup>6</sup>. Ndërsa, sipas një dokumenti të Drejtorisë IV të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, ambasada shqiptare në Beograd udhëzohej që të punonte për rritjen e nivelit të eksporteve dhe importeve me Kosovën gjatë vitit 1979. Ajo porositej që shkëmbimet tregtare me Kosovën të arrinin në 10 milionë dollarë (5 milionë për secilën palë), duke pasur një bilanc të drejtë midis eksportit dhe importit<sup>7</sup>. Nga treguesit e mësipërm vërehet qartë se marrëdhëniet tregtare me ndërmarrjet nga Kosova, kishin ardhur duke u rritur si në sasi ashtu edhe për sa i përket gamës së mallrave të shkëmbyera.

Ajo që përbënte risi në marrëdhëniet Shqipëri – Kosovë ishin padyshim shkëmbimet në arsimin e lartë, në kulturë e në shkencë. Kontaktet e para u vendosën në mesin e viteve 60-të, pas rënies së Rankoviçit. Më 1967, një delegacion i Universitetit të Prishtinës i bëri vizitë Universitetit të Tiranës, ndërsa në maj 1968 një delegacion me studiues dhe pedagogë nga Universiteti i Tiranës mori pjesë në

<sup>5</sup> *AQSH*, F. 14/AP-STR, V. 1978, D. 301, fl. 1-4, 26-30. Informacion mbi marrëdhëniet tregtare me firmat e Kosovës, përgatitur nga Nedin Hoxha, dërguar shokut Fiqiri, më 17 tetor 1978, Tiranë, 11 tetor 1978, Jorgo Themeli. Njoftim mbi marrëdhëniet tregtare të vendit tonë me Kosovën, Tiranë, 19 dhjetor 1978.

<sup>6</sup> *AMPJ*, V. 1979, D. 1218, fl. 14. Njoftim mbi gjendjen e shkëmbimeve tregtare me Kosovën, përgatitur nga Nedin Hoxha.

<sup>7</sup> *Po aty*, V. 1979, D. 1218, fl. 33. Për shkëmbimet tregtare me firmat kosovare, dërguar ambasadës në Beograd nga zëvendësministri Ksenofon Nushi, Tiranë, 12 janar 1979.

simpoziumin e organizuar për të përkujtuar 500-vjetorin e vdekjes së Skënderbeut në Prishtinë. Nga kontaktet dhe bisedimet e zhvilluara ndërmjet të dy palëve u hodh ideja e bashkëpunimit afatgjatë ndërmjet Universitetit të Tiranës dhe Universitetit të Prishtinës dhe fakulteteve përbërëse të tyre<sup>8</sup>. Këto përpjekje u konkretizuan me nënshkrimin e marrëveshjeve dhe protokolleve të bashkëpunimit. Në qershor të vitit 1968, u arrit një marrëveshje legale midis “Art-eksportit” dhe ndërmarrjes botuese “Rilindja” të Kosovës, fryt i së cilës ishte dërgimi në Kosovë në dy vitet në vazhdim, i mijëra librave shkencorë, mësimorë e kulturorë nga Shqipëria. Në vitin 1969 në Kosovë u dërguan 32 266 libra nga letërsia shqipe dhe përkthime nga letërsia e huaj, si dhe 650 tekste mësimore dhe dispensa të ndryshme për 42 lëndë. Gjatë këtij viti u dërguan gjithashtu edhe 20 970 mjete mësimore si, harta, globe, atlase, numëratore si dhe 60 000 pllaka gramafoni<sup>9</sup>. Sasia e dërgesave të kësaj natyre erdhi duke u rritur gjatë vitit 1970.

Marrëdhëniet e bashkëpunimit ndërmjet Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit të Tiranës, u zhvilluan në bazë të protokolleve të përbashkëta të firmosura për çdo vit, duke filluar me vitin akademik 1970-71 dhe duke përfunduar në vitin 1980. Por, duhet përmendur se, midis qeverisë shqiptare dhe asaj jugosllave deri në vitin 1970, nuk ekzistonte ndonjë program ndërshtetëror bashkëpunimi në fushat kulturore e arsimore. Në vitin 1970, qeveria jugosllave hartoi në Beograd të parin projekt - program bashkëpunimi për vitet 1971-1972 në fushat e arsimit dhe të kulturës ndërmjet të dy vendeve<sup>10</sup>. Projekti jugosllav që përmbante 39 nene dhe dy anekse iu dorëzua qeverisë shqiptare nëpërmjet ambasadës jugosllave në Tiranë. Por, pala shqiptare, pasi e shqyrtoi me kujdes refuzoi ta pranonte atë. Kontradiktat për një varg problemesh nuk ishin kapërcyer ende. Në këto rrethana, qeveria shqiptare hartoi një projekt tjetër, të përbërë nga 23 nene dhe një aneks. Por, edhe projekti i qeverisë shqiptare ndeshi në refuzimin e palës jugosllave, e cila nuk e pranoi atë. Ndërkohë, as bisedimet e zhvilluara në muajt qershor-korrik të vitit 1971, për të arritur që të nënshkruanin një marrëveshje kulturore dhe arsimore midis

<sup>8</sup> ASHAK, Fondi: Sekretariati Krahinor për marrëdhënie me botën e jashtme, viti 1972-1984, Nr. i lëndës 1-97, kutia 4, fl. 22, 24. Bashkëpunimi arsimor, shkencor dhe kulturor i KSA të Kosovës me RPS e Shqipërisë.

<sup>9</sup> AMPJ, V. 1970, D. 583, fl. 45. Informacione nga MPJ.

<sup>10</sup> Po aty, V. 1971, D. 661, fl. 38-48.

Shqipërisë e Jugosllavisë për vitet 1971-1972 nuk patën sukses<sup>11</sup>. Duke mos gjetur mirëkuptim iu hap rruga bashkëpunimit të drejtpërdrejtë të institucioneve arsimore e kulturore të Shqipërisë e Kosovës, pa pasur marrëveshje ndërshtetërore. Ai gjeti zbatim përmes marrëveshjeve të nivelit lokal-konkretisht ndërmjet të dy universiteteve, shtëpive botuese, bibliotekave, arkivave e muzeve, radiove e televizioneve përkatëse, shkëmbimeve të shoqërive kulturo-artistike e sportive, në lëmin e filmit, të pjesëve teatrale etj. Një bashkëpunim i kësaj natyre duket se u favorizua nga kushtet dhe koniunktura ndërkombëtare të ndërlikuara, ku rolin vendimtar duket se e kishin marrëdhëniet e tensionuara nacionale në Jugosllavi, Serbi e Kosovë<sup>12</sup>.

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, me vendimin e datës 24 qershor 1970, vendosi t'u jepte bursë për të vazhduar studimet e larta në Shqipëri për vitin akademik 1970-1971, 75 studentëve nga Kosova. Gjithashtu u vendos që të jepeshin edhe 50 bursa për të vazhduar shkollat e mesme në profilin pedagogjik, industrial dhe mjekësor. Për vitet 1971-1975 të rinjve dhe të rejave nga Kosova do t'u akordoheshin çdo vit nga 75 deri në 100 bursa për të ndjekur shkollat e larta dhe 50 për të vazhduar shkollat e mesme. Veç kësaj, Universiteti Shtetëror i Tiranës duhej të pranonte çdo vit gjer në 5 kuadro të lartë nga Kosova, të cilët do të përgatitnin mbrojtjen e disertacioneve, për marrjen e gradës "Kandidat i shkencave". Vendimi i lartpërmendur i ngarkonte Universitetit të Tiranës detyrimin, që gjatë vitit 1971 të pranonte, 20 studiues nga Kosova, për të përfutur eksperiencë apo për t'u specializuar në Shqipëri<sup>13</sup>.

Më 27 tetor 1970, dy drejtuesit më të lartë të Universitetit të Tiranës dhe Universitetit të Prishtinës - Osman Kraja dhe Dervish Rozhaja nënshkruan në Tiranë, Protokollin për bashkëpunim ndërmjet këtyre dy universiteteve. Ai filloi të zbatohej që në dhjetor të atij viti, kur një grup pedagogësh të Universitetit të Tiranës shkuan në Kosovë<sup>14</sup>. Ndërsa, më 10

<sup>11</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj (1949-1990), përgatitur për botim nga grup autorësh, Tiranë: Toena, 2008, f. 312.

<sup>12</sup> Sabit Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*, (botim i dytë), Instituti i Historisë, Prishtinë: 2017, f. 239.

<sup>13</sup> *AMPJ*, V. 1970, D. B/VII-2 (nr. rendor 578), fl. 21-22. Vendim i Këshillit të Ministrave, 26 qershor 1970.

<sup>14</sup> Protokollin parashikonte ndihma konkrete të USHT për UP në këto drejtime kryesore: në ngritjen e nivelit të kuadrove të reja të UP duke shkuar nga Kosova për specializim dhe eksperiencë pranë katedrave dhe sektorëve të ndryshëm të Universitetit Shtetëror

dhjetor 1971 Jorgji Sota dhe Dervish Rozhaja nënshkruan në Prishtinë, Protokollin Ndëruniversitar për vitin akademik 1971-1972. Në vitet 1971-1972, 64 pedagogë të Universitetit Shtetëror të Tiranës [USHT] kanë mbajtur ligjërata në fakultete të ndryshme në Universitetin e Prishtinës [UP], përkatësisht 14 në Fakultetin Filozofik, 14 në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, 20 në Fakultetin Teknik, 9 në Fakultetin e Mjekësisë, 6 në Fakultetin e Drejtësisë dhe 1 në Fakultetin Ekonomik<sup>15</sup>.

Bashkëpunimi solli disa arritje shkencore brenda një kohe të shkurtër. U mbajtën një sërë konferencash me studiues nga të dy anët e kufirit, për ngjarje të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar, të tilla si: Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike e mbajtur në Tiranë nga data 12-18 janar 1968; Simpoziumi kushtuar 500-vjetorit të Gjergj Kastriotit Skënderbeut, në Prishtinë, 9-12 maj 1968; Sesioni Shkencor mbajtur në Tiranë, më 25 maj 1971, me rastin e 125-vjetorit të lindjes së shkrimtarit Naim Frashëri; Konferenca Kombëtare e Folkloristikës Shqiptare, mbajtur në Tiranë, më 26-27 maj 1972; Kuvendi i Parë i Studimeve Ilire, mbajtur në Tiranë, më 15-20 shtator 1972; Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, mbajtur në Tiranë, më 20-25 nëntor 1972<sup>16</sup> etj. Shkëmbimet e ekipeve sportive midis Kosovës dhe Shqipërisë

të Tiranës. Në dërgimin nga USHT i 50 kuadrove të saj mësimore-shkencorë pranë UP për të zhvilluar ligjërata dhe cikle leksionesh me studentë dhe kuadro të UP për rreth 25 lëndë si dhe me dërgimin nga ana e USHT të teksteve mësimore që ajo vetë do t'i botojë. Në kuadër të këtij procesi, brenda një viti, në Kosovë nga Shqipëria shkuan 7 grupe pedagogësh me gjithsej 38 veta për leksione e konferenca pasuniversitare si dhe u dërguan 8 specialistë për cikle të shkurtra ligjërata dhe për ligjërata të veçanta. USHT për katedrat e UP dërgoi edhe nga 5 ekzemplarë të të gjitha botimeve të veta të fundvitit ndërsa nga botimet e mëparshme u dërguan rreth 200 tituj me rreth 900 ekzemplarë. Botimet e reja u dërguan nëpërmjet "Arteksportit" dhe "Rilindjes", në sasi të parashkuara në kontratat e nënshkuara midis këtyre dy enteve. Në këtë rrugë janë dërguar 80 tituj me rreth 1000 ekzemplarë. Po ashtu, brenda kësaj periudhe nga Kosova në Shqipëri, kanë shkuar rreth 300 veta të sektorëve të ndryshëm të arsimit dhe të kulturës. Shumica prej tyre kanë qenë mësues dhe nxënës të shkollave 8-vjeçare, gjimnazeve, të instituteve pedagogjike 2-vjeçare dhe pjesa tjetër e sektorëve të kulturës. Po ashtu, gjatë periudhës 1-vjeçare pati shumë vajtje e ardhje delegacionesh nga të dyja vendet. Shih: *AMPJ*, V. 1971, D. 639, fl. 13-19, 30. Informacion mbi marrëdhëniet me Kosovën, 18 qershor 1971.

<sup>15</sup> *ASHAK*, Fondi: Sekretariati Krahinor për marrëdhënie me botën e jashtme, viti 1962/1984, Nr. i lëndës 1-55, kutia 1, fl. 21-22. Informata mbi Bashkëpunimin Kulturor-Arsimor me RP të Shqipërisë, dhjetor 1973.

<sup>16</sup> *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. IV, f. 291.

datojnë që nga viti 1971, ndërsa vizitat e shoqërive kulturore-artistike nga Shqipëria, që nga viti 1972<sup>17</sup>.

Për vitin akademik 1972-1973, Protokolli u nënshkrua nga Agim Mero dhe Dervish Rozhaja. Gjatë viteve 1972-1973, u nënshkruan kontrata dhe u dërgua në Kosovë literaturë shkollore dhe artistike si dhe u vendosën kontakte me institucione të ndryshme. Rreth 1200 shqiptarë nga Kosova vizituan Shqipërinë dhe 300-400 persona nga Shqipëria vizituan Kosovën<sup>18</sup>. Gjatë vitit 1973, marrëdhëniet patën një intensitet më të ulët, prirje e cila u theksua më shumë gjatë vitit 1974. U ndërpre dërgimi i librit dhe i mjeteve të tjera mësimore, pati kufizime në shkëmbimin e grupeve, por sidoqoftë marrëdhëniet nuk u ndërpreën. Protokolli i vitit 1973-1974, i firmosur në Prishtinë më 23 janar 1974 nga Perikli Prifti dhe Idriz Ajeti, do të realizohej në mënyrë të kënaqshme. Gjatë vitit 1974, UT dërgoi në Prishtinë një numër kuadrosh pranë UP, e për herë të parë u bë udhëheqja e diplomës së studentëve nga Kosova, prej pedagogëve të UT. Po ashtu, nga Prishtina shkuan kuadro pranë UT. Si rezultat i bashkëpunimit, u mbajtën ligjërata të veçanta e të shkallës së tretë pasuniversitare, specializime, shkëmbim përvoje, kërkime arkivore e bibliografike, ekspedita të përbashkëta në fushat e gjuhësisë, etnografisë, folklorit, arkeologjisë, arteve mesjetare etj. Gjithashtu, në Shqipëri shkuan disa grupe arsimtarësh e piktorësh nga Kosova e Maqedonia. Nga Shqipëria u dërguan në Kosovë ansamble folkloristike, ndërsa Radio Tirana dërgoi incizime e pllaka, kryesisht të muzikës popullore etj<sup>19</sup>.

Më 30 dhjetor 1974 u parashtrua plani i aktiviteteve të Shqipërisë me Kosovën dhe me shqiptarët e Maqedonisë e të Malit të Zi për vitin 1975<sup>20</sup>. Bashkëpunimi Shqipëri-Kosovë gjatë vitit 1975, megjithëse shënoi disa arritje, vazhdoi të prirej drejt rënies<sup>21</sup>. Në këtë vit numri i paraqitjes së krijimeve letrare nga Shqipëria në Kosovë e në Maqedoni

<sup>17</sup> *ASHAK*, Fondi: Sekretariati Krahinor për marrëdhënie me botën e jashtme, viti 1972-1984, Nr. i lëndës 1-97, kutia 4, f. 36-37. Bashkëpunimi në sferat e artit muzikor dhe në lëmin e kulturës fizike.

<sup>18</sup> *AMPJ*, V. 1974, D. 468, fl. 43-46. Vlerësim i realizimit të objektivave ndaj Kosovës nga Drejtoria IV, 21 tetor 1974.

<sup>19</sup> *Po aty*, V. 1974, D. 468/1, fl. 46-50. Informacion nga Drejtoria IV, mbi marrëdhëniet e Shqipërisë me Kosovën gjatë 9 muajve të vitit 1974, 15 tetor 1974.

<sup>20</sup> *Po aty*, V. 1974, D. 469, fl. 19-23. Plan i aktiviteteve në drejtim të Kosovës e shqiptarëve të Maqedonisë e të Malit të Zi, 30 dhjetor 1974.

<sup>21</sup> *Po aty*, V. 1976, D. 776, fl. 13-18. Përgjigje e Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Degës IV, 28 shkurt 1976.

vazhdoi të ulej në krahasim me dy vitet e mëparshme, ndërsa shfaqja e veprimtarive artistike ishte pothuajse e pandjeshme. U ndërpre në vizitat reciproke ndërmjet të dy palëve, ndërsa u kufizuan shumë botimet letrare të krijuesve e studiuesve të Kosovës në Shqipëri<sup>22</sup>. Megjithatë, gjatë gjysmës së parë të vitit 1975, u zhvilluan disa lloj marrëdhëniesh e që mund të përmbliidhen në bashkëpunimin midis dy universiteteve, në shkëmbimin e ndonjë trupe artistike apo ekipi sportiv dhe në disa shkëmbime të karakterit tregtar të artikujve të karakterit artistik dhe librave të ndryshme. Vend të rëndësishëm në këto marrëdhënie zunë edhe vizitat e disa grupeve, sidomos arsimtarësh dhe nxënësish, të cilët vizituan Shqipërinë dhe përfituan nga praktika e zhvillimit arsimor të shtetit amë<sup>23</sup>.

Ministria e Arsimit dhe Kulturës në Shqipëri më 28 shkurt 1976, hartoi planin e bashkëpunimit për vitin 1976 me Kosovën, Maqedoninë dhe Malin e Zi. Plani parashihte që të ndiqte zbatimin e protokolleve të përfunduara midis USHT me UP, në fushën e arsimit, kulturës dhe arteve, radiotelevizionit e tregtisë<sup>24</sup>. Por, në këtë vit, sikurse edhe në vitin 1975 marrëveshja e nënshkruar nuk u arrit të finalizohet si duhej. Procesi i rënies nuk po ndalej. Ai po bëhej prirje nga viti në vit. dukej se nuk po ndalej. Në Kosovë e Maqedoni po pakësohej shumë numri i botimeve letrare të shkrimtarëve nga Shqipëria. Megjithatë, edhe pse gjatë vitit 1976, Sektori i Jashtëm i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë bëri një punë shumë të kufizuar për të njohur e përhapur letërsinë, artet, mendimin teorik e estetik si dhe arritjet e tjera në Kosovë e Maqedoni, Lidhja e Shkrimtarëve të Shqipërisë arriti të dërgonte atje gazetën “Drita” dhe revistën “Nëntori”. Në fushat e tjera të parashikuara për vitin 1976, Sektori i Jashtëm nuk mundi të kryejë asnjë aktivitet. Ai nuk u njoh fare me krijimtarinë letrare e artistike të studiuesve nga Kosova e Maqedonia. Po ashtu, “Drita” dhe “Nëntori”, nuk botuan asnjë

<sup>22</sup> *Po aty*, V. 1976, D. 775, fl. 80-81. Relacion i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, 3 janar 1977.

<sup>23</sup> *Po aty*, V. 1975, D. 651/1, fl. 40-43. Informacion i Drejtorisë V.

<sup>24</sup> *Po aty*, V. 1976, D. 776, fl. 19-29. Plani i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës në drejtim të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi, 28 shkurt 1976.

Iloj krijimtarie të këtyre dy trevave e nuk u realizua asnjë këmbim vizitash ndërmjet grupeve nga të dyja palët sikundër ishte planifikuar<sup>25</sup>.

Më 27 dhjetor 1976, u miratua plani i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës të Shqipërisë në drejtim të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi për vitin 1977, plan i cili kishte si synim, të ndihmonte aktivisht organet dhe institucionet e arsimit, kulturës dhe të arteve të këtyre trevave. Për këtë qëllim u morën një sërë masash, ashtu si më parë në fushën e arsimit, kulturës dhe të arteve si dhe u dërguan në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, grupe arsimtarësh e delegacionesh të ndryshme<sup>26</sup>.

Gjatë vitit 1977 vazhduan kontaktet Shqipëri-Kosovë. 32 studiues e pedagogë të Universitetit të Tiranës mbajtën cikle të plota leksionesh dhe asistuan në provimet e 17 lëndëve mësimore-shkencore në Kosovë. Gjithashtu u mbajtën 7 tema me studentët pasuniversitarë dhe një ligjëratë e veçantë. Nga ana tjetër, 41 pedagogë e kërkues shkencorë të Universitetit të Tiranës shkuan në Kosovë pranë Universitetit të Prishtinës për përvojë, specializime, kërkime shkencore dhe për ligjërata të veçanta. Megjithatë, plani i bashkëpunimit të Shqipërisë me Kosovën për vitin akademik 1976-1977 u realizua përafërsisht në masën 65 për qind<sup>27</sup>. Bashkëpunimi Shqipëri-Kosovë gjeti zbatim edhe në disa fusha të tjera. Kështu, më 1977, Tirana priti disa grupe studentësh nga Kosova, si dhe ekipet e basketbollit të UP, punonjës të “Kosovafilm”, të Televizionit të Prishtinës etj. Shtëpia Botuese “Naim Frashëri” në Tiranë botoi dy vëllime me poezi për fëmijë dhe 2 vëllime me poezi për të rritur të autorëve nga Kosova. Gazeta “Drita”, botoi 6 poezi të 3 autorëve kosovarë. Revista “Nëntori”, botoi 9 poezi. Një punë e mirë u bë edhe për dërgimin e literaturës në Kosovë. Shqipëria dërgoi në 12 bibliotekat e Kosovës 122 tituj botimesh me 184 ekzemplarë, botimet periodike etj. Ndërmarrja e librit të Shqipërisë realizoi një kontratë më të madhe se në vitet e mëparshme me ndërmarrjen “Rilindja”. Nga 90 884<sup>28</sup> libra që u

<sup>25</sup> Gjatë këtij viti, vetëm në dhjetor të vitit 1976 erdhën nga Shqipëria në Kosovë jashtë planit, dy shkrimtarë të letërsisë për fëmijë të ftuar nga revista “Pionieri” e Prishtinës. Shih: *AMPJ*, V. 1976, D. 775, fl. 70-72.

<sup>26</sup> *AMPJ*, V. 1977, D. 1112, fl. 1-6. Plan i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës në drejtim të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi, 27 dhjetor 1976.

<sup>27</sup> *Po aty*, V. 1977, D. 1113, fl. 15. Relacion i MPJ, për realizimin e detyrave ndaj Kosovës gjatë vitit 1977.

<sup>28</sup> Gjatë vitit 1977 janë bërë edhe dërgesa të tjera, si: Teatri Popullor i Tiranës i dërgoi atij të Prishtinës dhe Gjakovës tekste dramash. Ansambli “Shota” iu dërguan incizime të ndryshme. Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve dërgoi dy shkrimtarë në mitingun e

dërguan në Kosovë, 22 892 ishin të karakterit politiko-shoqëror (kryesisht vepra të Marksit, Engelsit e Leninit), 20 022 libra tekniko-shkencorë dhe 47 920 libra të letërsisë artistike. Përveç Kosovës, Ndërmarrja e librave të Shqipërisë dërgoi një sasi librash edhe në viset e tjera shqiptare si dhe në vende të ndryshme të botës, ku kishte emigracion shqiptar nga Kosova, si në: Belgjikë, Australi, Zvicër, Gjermani, SHBA, Kanada<sup>29</sup> etj. Edhe përfaqësitë diplomatike të shtetit shqiptar, shpërndanë materiale lidhur me Kosovën sikurse kanë qenë libri “Shotë dhe Azem Galica” e “Isa Boletini”<sup>30</sup>.

Më 7 janar 1978, Ministria e Arsimit dhe Kulturës hartoi planin e bashkëpunimit për këtë vit me Kosovën, Maqedoninë dhe Malin e Zi. Plani synonte në mënyrë të veçantë që të zgjeronte shkëmbimet me viset shqiptare nën Jugosllavi, me qëllim që të ndikonte në rritjen e ndërgjegjes kombëtare të banorëve të tyre. Lidhur me këtë çështje, ashtu si më parë, u morën një sërë masash në fushën e arsimit, kulturës dhe të arteve e në fushën e kulturës fizike e sporteve<sup>31</sup>. Gjatë këtij viti u synua sidomos tek zgjerimi i botimeve nga Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, bashkëpunim më i mirë në aspektin radio-televiziv, shtimi i marrëdhënieve ndërmjet të dy universiteteve, përmirësimi i punës së Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë etj<sup>32</sup>. Shtëpia Botuese ‘Naim Frashëri’ në periudhën kohore 1971-1978 kishte botuar 6 romane, 4 vëllime me tregime, 11 vëllime me poezi dhe 5 libra për fëmijë, me autorë nga Kosova.

Universiteti i Tiranës dhe Universiteti i Prishtinës për të zhvilluar e forcuar më tej lidhjet dhe bashkëpunimin midis tyre, hartuan Projekt-Protokollin e bashkëpunimit mësimor e shkencor, për vitin akademik

---

poezisë në Gjakovë etj. Po ashtu, sipas objektivave dhe planit të Bibliotekës qenë përgatitur edhe 2 kontingjente librash shkencorë dhe artistikë prej 147 titujsh dhe komplete tekstesh shkollore të 8-vjeçares, që me rastin e vizitës në Kosovë, t’ua dhuronte bibliotekave të Kosovës. *Po aty*, fl. 17-18.

<sup>29</sup> *Po aty*, V. 1977, D. 1115, fl. 35. Informacione nga MPJ dhe përfaqësitë diplomatike.

<sup>30</sup> *Po aty*, V. 1980, D. 1161, fl. 65-66, 77. Informacione për marrëdhëniet e Shqipërisë me Kosovën dhe Jugosllavinë.

<sup>31</sup> *Po aty*, V. 1978, D. 1261, fl. 1-5. Plani i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës në drejtim të Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi, 7 janar 1978.

<sup>32</sup> *AQSH*, F. 14/AP-STR, V. 1978, D. 302, fl. 3-14. Program masash mbi disa aktivitete në drejtim të Kosovës për vitin 1978 nga institucione të ndryshme.

1978-1979<sup>33</sup>. Bisedimet e para për nënshkrimin e këtij Protokollit kishin filluar më 2 tetor 1978, ndërsa Protokollit u nënshkrua, më 9 tetor 1978. Për palën kosovare nënshkroi rektori i UP-së, Feriz Krasniqi, ndërsa për Universitetin e Tiranës zëvendësrektori Besim Daja<sup>34</sup>. Projekti në fjalë, krahasuar me atë të miratuar në vitin 1978 mund të konsiderohej si një përsëritje e tij. Megjithatë, në këtë projekt, UT merrte përsipër të dërgonte në Prishtinë 89 pedagogë, duke bërë kështu një rritje prej 7 pedagogësh, në krahasim me 82 që ishin vitin e kaluar (realizuar 73). Ndërkaq, parashikohej që Tirana të priste 92 pedagogë të UP (sipas kërkesave të UP), ndërsa në vitin 1978 ishin parashikuar vetëm 66 pedagogë të UP, nga të cilët mbërritën në Shqipëri vetëm 59 prej tyre. Rritja e numrit të pedagogëve të UP për t'u pritur në Shqipëri, në krahasim me vitin e kaluar qe më e madhe, 36 veta<sup>35</sup>. Deri më 30 qershor 1979, protokollit i lartpërmendur mësimor e shkencor nuk ishte realizuar plotësisht.<sup>36</sup>

Protokollit i bashkëpunimit mësimor e shkencor midis Universitetit të Tiranës e Universitetit të Prishtinës për vitin mësimor 1980-1981, u nënshkrua nga rektorët e të dy Universiteteve përkatësisht nga Petrit Radovicka dhe nga Gazmend Zajmi<sup>37</sup>. Po ashtu, Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqata e Kompozitorëve të Kosovës, me qëllim që të vendosnin e forconin më tej marrëdhëniet midis tyre, miratuan një Protokoll të veçantë bashkëpunimi për vitet 1980-1981. Ky protokoll fokusohej tek shkëmbimi i përvojës e

<sup>33</sup> *AMPJ*, V. 1978, D. 1262/1, fl. 19-21. Projekt Protokollit i Bashkëpunimit mësimor e shkencor midis Universitetit të Tiranës dhe Universitetit të Prishtinës, për vitin shkollor 1978/1979.

<sup>34</sup> *Po aty*, fl. 36-41. Mbi vizitën e delegacionit të UT që shkoi në Prishtinë, për nënshkrimin e Protokollit mësimor e shkencor për vitin 1978-1979. Kryetari i delegacionit Besim Daja, Tiranë, 16 tetor 1978.

<sup>35</sup> *Po aty*, fl. 22. Informacion ditor.

<sup>36</sup> *AQSh*, F. 14/AP-STR, V. 1979, D. 63, fl. 306-307. Relacion, mbi realizimin e Protokollit të bashkëpunimit mësimor e shkencor midis UT, nga njëra anë, dhe UP e UMKSH nga ana tjetër, për vitin shkollor 1978-1979.

<sup>37</sup> *AMPJ*, V. 1980, D. 1182, fl. 1-5. Protokoll i bashkëpunimit mësimor e shkencor midis Universitetit të Tiranës e Universitetit të Prishtinës për vitin mësimor 1980-1981. Protokollit ishte miratuar nga zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave në Tiranë, Manush Myftiu, më 27 maj 1980.

konsultimeve, tek ligjëratat, shkëmbimet e materialeve muzikore, tek botimet e ndryshme dhe tek shkëmbimet e vizitave<sup>38</sup>.

Në nëntor të vitit 1978, u nënshkrua Protokollin mbi Bashkëpunimin midis Radio Televizionit të Prishtinës dhe Radio Televizionit Shqiptar. Në zbatim të saj u këmbyen filma edukativë e shkencorë të popullarizuar, filma dokumentarë-fejtonistik, emisione muzikore, pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme, pati bashkëpunim në fushën teknike etj.<sup>39</sup> Akademia e Shkencave të Republikës Socialiste të Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, në vazhdim të frymës së mirëkuptimit dhe dëshirës së tyre për bashkëpunim miratuan Protokollin dyvjeçar të bashkëpunimit për vitet 1979 – 1980. Protokollin dyvjeçar përqendrohej tek shkëmbimi i përvojës e konsultime, tek kërkimet arkivore e bibliografike, ekspeditat shkencore, ligjëratat dhe tek shkëmbimet e literaturës shkencore. Ky bashkëpunim ndërakademik u nënshkrua në Prishtinë, më 16 qershor 1979, nga Syrja Pupovci dhe Luan Omari<sup>40</sup>. Ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit Shqiptar dhe Drejtorisë së Arkivit të Kosovës u arrit marrëveshja e bashkëpunimit kërkimor-shkencor për vitet 1980-1981. Projekti i kësaj marrëveshjeje ishte miratuar më 21 mars 1980 nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë<sup>41</sup>.

Gjatë vitit 1980, u vazhdua bashkëpunimi i mëtejshëm Shqipëri-Kosovë, duke u bazuar në përvojën dhe rezultatet e mëparshme pozitive. Si rezultat u thellua më tej prania e shtetit amë në Kosovë dhe në viset e tjera

<sup>38</sup> *Po aty*, V. 1980, D. 1193, fl. 1-7. Protokoll i bashkëpunimit, në mes Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Republikës së Shqipërisë e Shoqatës së Kompozitorëve të Kosovës, 1980-1981.

<sup>39</sup> *AQSH*, F. 14/AP-STR, V. 1979, D. 64, fl. 75-77. Relacion, Drejtori i RTV Shqiptar, Çajup Rusmali, Tiranë, 5 prill 1979; *AMPJ*, V. 1978, D. 1262, fl. 1-20. Program i RTV Shqiptar për shkëmbime të ndryshme me RTV e Prishtinës për vitin 1978, drejtori, Çajup Rusmali, Tiranë, 21 janar 1978. Mbi marrëdhëniet me Radiotelevizionin e Prishtinës, zv. kryetari i Këshillit të Ministrave, Manush Myftiu, Tiranë, 22 maj 1978.

<sup>40</sup> *ASHAK*, Fondi: Sekretariati Krahinor për marrëdhënie me botën e jashtme, viti 1972-1984, Nr. i lëndës 1-97, kutia 4, f. 25. Bashkëpunimi ndërakademik; *AMPJ*, V. 1980, D. 1194, fl. 1-5. Protokoll për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit kërkimor-shkencor midis Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave e të Arteve të Kosovës për vitet 1979 dhe 1980.

<sup>41</sup> *AMPJ*, V. 1980, D. 1195, fl. 1-11. Marrëveshje e bashkëpunimit kërkimor-shkencor mes Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit Shqiptar dhe Drejtorisë së Arkivit të Kosovës, 1980-1981.

shqiptare nën Jugosllavi, sidomos përmes vazhdimësisë së aktiviteteve arsimore e kulturore. Vazhdoi zbatimi i protokolleve midis UT dhe atij të Prishtinës, Akademisë së Shkencave, Radiotelevizionit, Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve e Shoqatave të Kompozitorëve, të artistëve të artit figurativ e aplikativ, ndërmarrjes së Librit “Rilindja” në Kosovë dhe analoges së saj në Shqipëri etj.<sup>42</sup>

Si rrjedhojë e bashkëpunimit shumëvjeçar ndëruniversitar u bë e mundur që në degët e ndryshme të fakulteteve të UP-së, si Fakultetin e Mjekësisë, Teknik, Xehetar-Metalurgjik, Matematiko-Natyror dhe Akademinë e Arteve të zhvillohen 23 lëndë mësimore në gjuhën shqipe, të cilat më parë i zhvillonin profesorët serbë në gjuhën serbo-kroate. Pedagogët e UT-së, gjatë një viti shkollor, mbajtën mesatarisht 2 123 orë ligjërata dhe 292 orë ushtrime, si dhe provimet nga lëndët që i zhvillonin ciklet e ligjëratave të shkallës III në Fakultetin Filozofik<sup>43</sup>. Në bazë të të dhënave që disponojmë, në Universitetin e Prishtinës janë angazhuar një numër i madh pedagogësh e studiuesish nga Universiteti i Tiranës dhe Akademia e Shkencave të Shqipërisë, janë angazhuar për të mbajtur ligjërata me studentët e fakulteteve të ndryshme të Universitetit të Prishtinës. Sipas statistikave që kemi mund të përmendim se: për vitin 1970-71 kanë mbajtur ligjërata të rregullta 29 profesorë nga Shqipëria; në vitin shkollor 1971-72, 30 profesorë; në vitin shkollor 1972-73, 32

<sup>42</sup> Gjatë vitit 1980 u pritën në Shqipëri 166 grupe nga Kosova, Maqedonia e Mali i Zi, me gjithsej 1502 persona, shifra këto pak a shumë të të njëjtit nivel të një viti më parë. Në këto grupe përfshiheshin si grupet artistike ashtu edhe të gjitha grupet e tjera të ardhura në kuadër të bashkëpunimit midis institucioneve. Veç këtyre janë miratuar gjatë vitit 1200 viza individuale dhe shkuan në Shqipëri 903 veta. Ndërkaq, nga ana e institucioneve të Shqipërisë u dërguan në Kosovë e vise të tjera, 97 grupe me 812 persona, duke shënuar një rritje prej rreth 30 grupesh, si rezultat i zbatimit të një numri marrëveshjesh të reja që janë nënshkruar. Janë akorduar edhe rreth 480-500 viza individuale për të vajtur (ardhur) nga Shqipëria në Kosovë e vise të tjera. Nga grupet e pritura nga Shqipëria, 135 kanë qenë nga Kosova, 14 nga Maqedonia dhe 17 nga Mali i Zi, ndërsa nga grupet e dërguara nga Shqipëria, 92 shkuan në Kosovë, 4 në Maqedoni e 1 në Mal të Zi. Në marrëdhëniet midis bibliotekave, nga ajo e Tiranës i janë dërguar Bibliotekës së Prishtinës 1 669 copë libra nga 2 217 që qenë dërguar gjithsej në Kosovë. Ndërsa, nga Biblioteka e Prishtinës janë dërguar rreth 220 copë libra. Biblioteka e Tiranës dërgoi edhe në Mal të Zi, 210 copë libra e për gjimnazet e Dibërës, Gostivarit e Kumanovës, 283 copë. Shih: *AMPJ*, V. 1980, D. 1161, fl. 16-19.

<sup>43</sup> *ASHAK*, Fondi: Sekretariati Krahinor për marrëdhënie me botën e jashtme, viti 1972-1984, Nr. i lëndës 1-97, kutia 4, fl. 23. Bashkëpunimi arsimor-shkencor dhe kulturor, Prishtinë, shtator 1980.

profesorë; në vitin shkollor 1973-74, 28 profesorë; në vitin shkollor 1974-75, 26 profesorë; në vitin shkollor 1975-76, 24 profesorë, ndërsa në vitin e fundit akademik 1980-81, 16 profesorë. Siç del nga statistikat e mësipërme bashkëpunimi Shqipëri-Kosovë në fushën e arsimit të lartë ishte një fenomen shumë pozitiv, por ai eci me zigzage. Duke filluar nga viti 1974 e më mbrapa numri i pedagogëve që vinin nga Tirana në Kosovë për të mbajtur ligjërata erdhi duke rënë. Në vitin 1972-73 ata mbulonin 3 % të mësimdhënies në Kosovë, ndërsa në vitin 1980-81 ai u zvogëluar në 1,6%<sup>44</sup>. Rënia duhet shpjeguar jo me mungesën e vullnetit të shqiptarëve nga të dy anët e kufirit, por me keqësimin e marrëdhënieve politike e shtetërore ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë, pas kërkesave të shqiptarëve për të pasur republikën e tyre të Kosovës brenda Jugosllavisë. Bashkëpunimi i drejtpërdrejtë i Shqipërisë me Kosovën ndeshi në kundërshtimin e udhëheqjes së lartë jugosllave e cila e frenoi dhe e ndaloi këtë proces pozitiv. Pas Plenumit X të Komitetit Qendror të mbajtur në muajin qershor 1981, pas gjendjes represive që u krijua në Kosovë nga autoritetet jugosllave, qeveria shqiptare u detyrua që të ndërpriste marrëdhëniet kulturore dhe arsimore me Jugosllavinë. Por, sidoqoftë vazhduan përpjekjet për të ndihmuar popullsinë shqiptare të Kosovës përmes radios, televizionit dhe mbështetjes së emigracionit të saj në disa vende të Evropës.

Periodha e analizuar më sipër mund të konsiderohet pa hezitim si më e mira në marrëdhëniet e shqiptarëve të Shqipërisë dhe Kosovës e viseve të tjera nën Jugosllavi.

### *S u m m a r y*

#### THE RELATIONS BETWEEN ALBANIA AND KOSOVA DURING THE SEVENTIES

The economic relations between Albania and Kosova started in the sixties. The seventies of the 20<sup>th</sup> century were characterized by increased interest of Tirana's political leadership for Kosova and the other Albanian territories under

---

<sup>44</sup> *Po aty*, fl. 6. Mbështetur në një dokument tjetër të ASHAK, nga USHT kanë mbajtur ligjërata në UP prej vitit 1970-1972 në fakultete të ndryshme, 64 pedagogë e jo 59 siç na jep shifrën dokumenti i lartcituat. ASHAK, Fondi: Sekretariati Krahinor për marrëdhënie me botën e jashtme, viti 1962/1984, Nr. i lëndës 1-55, kutia 1, fl. 21-22. Informata mbi Bashkëpunimin Kulturor-Arsimor me RP të Shqipërisë, dhjetor 1973.

Yugoslavia. This policy found satisfactory implementation, especially in the field of education and culture. The improvement of relations between Albania and Kosova should be seen closely related to the international developments, the internal group conflicts in Yugoslavia, and Tito's efforts to strike balance within the country. They demand national rights and independent institutions from Serbia, additionally to that, with the increasing interests of the Albanian state to improve her relations with Yugoslavia, and in particular with the Albanian population in Yugoslavia. In the beginning of the seventies conditions were enabled to establish direct contacts between Albania and Kosova. This phenomenon happened for the first time since the end of World War II. After improving the Yugoslav-Albanian relations, the two countries exchanged diplomatic representatives, and established conditions for having direct relations between Kosova and the Albanian state. Taking into consideration the fact that two countries despite this momentum of closeness have had significant differences in governance systems, to Kosova Albanians these relations would be intense in cultural, educational, scientific and other spheres of political life.

Between the State University of Tirana (STU) and the University of Prishtina (UP) protocols were signed, aiming to provide assistance in raising the level of new academic staff, specialization and experience to the various departments and sectors of the STU, and exchanging academic teaching personnel of the University of Tirana with students and staff of the UP. The Academy of Sciences of the Republic of Albania and the Academy of Sciences and Arts of Kosova, signed also the Protocol of cooperation: exchange of experiences and consultation, bibliographic archival research, scientific field expeditions, lectures and exchanges of scientific literature. The League of Writers and Artists of Republic of Albania and Kosova Association of Composers in order to establish and further strengthen relations, adopted also the Protocol for implementation of the cooperation agreement consisting on exchange of experiences and consulting, lectures, exchange of musical materials, publications and exchange of visits. The cooperation was agreed on scientific research between the General Directorate of Albanian State Archives and the Directorate of Archives of Kosova, and Radio Television of Tirana and Radio Television of Prishtina.